



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

KOMUNA E GJAKOVËS



Raport me informata të përgjithshme nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale





Ky raport ka për qëllim të paraqesë në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar para Asamblesë Komunale gjendjen e përgjithshme të shërbimeve shëndetësore gjatë periudhës njëvjeçare në komunë. Përmes këtij raporti synohet të ofrohet një pasqyrë e plotë mbi aktivitetet e realizuara nga institucionet shëndetësore, nivelin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, arritjet kryesore në fushën e shëndetësisë, si dhe sfidat me të cilat është përballur sektori gjatë kësaj periudhe.

Gjithashtu, raporti përfshin informacione mbi gjendjen epidemiologjike në komunë, trendet kryesore shëndetësore, masat e ndërmarra për parandalimin dhe menaxhimin e sëmundjeve, si dhe ndikimin e tyre në shëndetin publik. Një pjesë e rëndësishme i kushtohet edhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale, përmirësimit të infrastrukturës shëndetësore dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve.

Ky dokument synon të shërbejë si bazë e besueshme për analizë, monitorim dhe vlerësim të punës së sektorit të shëndetësisë, si dhe të ndihmojë Asamblenë Komunale në marrjen e vendimeve të informuara për planifikimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore në komunë.

Hyrje

Sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në komunë përbën një nga shtyllat kryesore të shërbimeve publike, me rol thelbësor në garantimin e kujdesit shëndetësor dhe mbështetjes sociale për qytetarët. Gjatë periudhës raportuese, institucionet përgjegjëse kanë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore, të qasshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha kategoritë e popullsisë.

Në kuadër të këtij sektori, janë përfshirë shërbimet e kujdesit shëndetësor primar, shërbimet emergjente dhe preventive, si dhe shërbimet e mirëqenies sociale që synojnë mbështetjen e familjeve në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe kategorive tjera të ndjeshme sociale. Aktivitetet janë orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve dhe forcimit të sistemit të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale në nivel lokal.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është një nga drejtoritë komunale, e cila ka për mision planifikimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve shëndetësore dhe sociale në nivel lokal. Kjo drejtori synon të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, të qasshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët e komunës, duke u fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit publik dhe mirëqenies sociale.

Në kuadër të saj funksionojnë disa njësi dhe sektorë organizativë, të cilët bashkëpunojnë ngushtë për realizimin e objektivave të përbashkëta dhe zbatimin e politikave komunale në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale:

Sektori për Shëndetësi

Ky sektor merret me planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e shërbimeve shëndetësore në nivel komunal, duke përfshirë kujdesin shëndetësor primar, shërbimet parandaluese, emergjente dhe aktivitetet për promovimin e shëndetit publik.

Sektori për Mirëqenie Sociale

Sektori për Mirëqenie Sociale është përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave sociale, me fokus në mbështetjen e familjeve në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe kategorive të tjera të cenueshme sociale, përmes programeve dhe masave mbështetëse.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QKMF është institucioni kryesor i ofrimit të shërbimeve shëndetësore primare në komunë, ku ofrohen shërbime të mjekësisë familjare, shërbime urgjente, infermiore, diagnostike bazike dhe shërbime të kujdesit preventiv për qytetarët.

Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale ofron shërbime direkte sociale për qytetarët, përfshirë vlerësimin e gjendjes sociale, trajtimin e rasteve sociale, mbrojtjen e fëmijëve, si dhe ofrimin e ndihmës profesionale për individët dhe familjet në nevojë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) është njësi organizative e Komunës së Gjakovës dhe funksionon në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ajo përfaqëson institucionin kryesor të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH) për qytetarët e komunës, si veprimtari me interes të veçantë publik.

Veprimtaria e QKMF bazohet në zbatimin e konceptit të mjekësisë familjare, i cili është pjesë e sistemit unik shëndetësor të Republikës së Kosovës. Ky koncept siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe të vazhdueshme për individin dhe familjen në të gjitha fazat e jetës, të bazuara në evidencë shkencore. Mjeku



familjar paraqet pikën e parë të kontaktit të qytetarit me sistemin shëndetësor dhe njëkohësisht shërben si portë hyrëse dhe pikë referimi për shërbimet specialistike në nivelin e Kujdesit Parësor dhe nivelet tjera të kujdesit shëndetësor.

Shërbimet shëndetësore në QKMF Gjakovë ofrohen nga profesionistë shëndetësorë të licencuar dhe të kualifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë: specialistë të mjekësisë familjare, mjekë të përgjithshëm, stomatologë dhe specialistë të stomatologjisë, farmacistë, biokimistë klinikë, infermierë, teknikë laboratorikë, teknikë farmaceutikë, teknikë të stomatologjisë, profesionistë të radiologjisë, si dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë dhe bashkëpunëtorë profesionalë të përcaktuar sipas regjistrit zyrtar të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Odave përkatëse profesionale.

QKMF ofron këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:

- shërbime të promovimit dhe edukimit shëndetësor;
- shërbime të imunizimit dhe vaksinimit;
- shërbime parandaluese;
- shërbime kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike;
- shërbime emergjente dhe urgjente;
- menaxhimin e sëmundjeve kronike;
- shërbime për fëmijë, adoleshentë dhe të rinj;
- shërbime të shëndetit riprodhues;
- shërbime të shëndetit oral;
- shërbime të shëndetit mendor;
- shërbime të kujdesit shtëpiak dhe paliativ;
- si dhe furnizimin me barna nga Lista Esenciale e Barnave.

Organizimi i QKMF

Me qëllim të ofrimit efikas të shërbimeve shëndetësore, QKMF është e organizuar në këto njësi kryesore:

Departamenti i Mjekësisë Familjare, i cili përfshin:


- Sektorin e Mjekësisë Familjare;
- Njësinë e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH);
- Njësinë e Vaksinimit dhe Imunizimit;
- Sektorin e Shëndetit Oral Preventiv;
- Sektorin e Kujdesit Urgjent;
- Sektorin Konsultativ dhe Diagnostik (shërbime konsultative, kabineti radiologjik dhe laborator).



Sektori i Administratës, i cili përfshin:

- Zyrtarin për Mbështetje Ligjore;
- Zyrtarin për Arkiv;
- Zyrtarin për Teknologji Informativ;
- Zyrtarin për Administrimin e Depos;
- Asistentin për Arkë;
- personelin teknik dhe mbështetës.

Rrjeti i shtrirjes së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancave të Mjekësisë Familjare (AMF)



BARNATORJA QENDRORE E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE (QKMF)

Barnatorja Qendrore është njësi organizative e QKMF-së, e cila funksionon në përputhje me legjislacionin për veprimtarinë farmaceutike. Në QMF dhe AMF funksionojnë barnatoret doracake, të cilat furnizohen, menaxhohen dhe monitorohen nga Barnatorja Qendrore.

Nga Barnatorja Qendrore dhe njësitë e saj shpërndahen vetëm barnat nga Lista Esenciale e Barnave, të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe të përshkruara nga mjekët e mjekësisë familjare përmes recetave unike. Përgjashtimisht, mund të shpërndahen edhe barna të siguruara nga donatorët ose nga buxheti komunal.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Gjakovë është e shtrirë në territorin rural të komunës përmes rrjetit të Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancave të Mjekësisë Familjare (AMF), të cilat sigurojnë ofrimin e shërbimeve shëndetësore primare në mënyrë të decentralizuar dhe të qasshme për të gjithë qytetarët.

BURIMET NJERËZORE

Njëri ndër elementet më të rëndësishme të zhvillimit të sistemit që parashihet me politikat shëndetësore dhe me politikat zhvillimore të Komunës së Gjakovës, janë resurset humane, gjegjësisht stafi i sistemit të KPSH të Komunës. Stafi shëndetësor i trajnuar, i motivuar dhe aktiv në realizimin e planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, është një ndër shtyllat kryesore të sistemit të KPSH të Komunës. Këtu përfshihen mjekët e specializuar në MF, mjekët e përgjithshëm, specialistë të stomatologjisë, stomatologët si dhe infermierët e trajnuar/a përfshi ketu teknik dhe asistente te stomatologjise.

Në kuadër të funksionimit të Kujdesit Parësor Shëndetësor në komunën e Gjakovës, struktura e personelit është e organizuar sipas thirrjes profesionale dhe përfaqësimit gjinor, duke reflektuar një gamë të gjerë të profileve shëndetësore dhe mbështetëse që kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

Personeli shëndetësor përfshin mjekë të mjekësisë familjare, mjekë të përgjithshëm dhe specialistë të tjerë mjekësorë, të cilët mbulojnë shërbimet bazë dhe të specializuara në nivel parësor. Gjithashtu, një rol të rëndësishëm luajnë stomatologët dhe stomatologët në specializim, të cilët ofrojnë shërbime të shëndetit oral në mënyrë preventive dhe kurative.

Thirrja profesionale	F	M	Gjithsej
Specialist i Mjekësisë Familjare	23	12	35
Mjekë në specializim	0	2	2
Mjekë të përgjithshëm	22	21	43
Specialist të tjerë	1	0	1
Stomatolog – specialistë	3	2	5
Stomatolog në specializim	2	1	3
Stomatolog	17	10	27
Infermier	112	21	133
Ro-teknik	0	1	1
Teknik të dhëmbëve	8	6	14
Asistentë të stomatologjisë	44	1	45
Laborant superior	2	0	2
Teknik laborator	6	3	9
Farmacit	0	1	1
Teknik farmacist	4	1	5
Administrata – superior	1	0	1
Administrata	4	3	7
Shërbimi teknik	2	0	2
Vozitës	10	0	10
Gjithsej	261	85	346

Një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit përbëhet nga infermierët dhe personeli teknik, të cilët sigurojnë vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor, mbështetjen e pacientëve dhe funksionimin e përditshëm të shërbimeve në të gjitha njësitë shëndetësore. Po ashtu, laborantët, farmacistët dhe teknikët farmaceutikë kontribuojnë në diagnostikë, përpunimin e analizave dhe furnizimin me barna esenciale.

Struktura përfshin gjithashtu personel administrativ dhe teknik, i cili mbështet funksionimin organizativ dhe logjistik të institucioneve shëndetësore, si dhe shoferë që mundësojnë transportin dhe funksionimin e shërbimeve në terren.

Në përgjithësi, struktura e personelit karakterizohet nga një përfaqësim i gjerë profesional dhe gjinor, ku dominon stafi i profilit infermior dhe mjekësor, duke garantuar një mbulim të plotë të shërbimeve shëndetësore në nivel komunal dhe funksionim efikas të sistemit të Kujdesit Parësor Shëndetësor.

VAKSINIMI

Njësia e Vaksinit dhe Imunizimit përbën një nga shërbimet më të rëndësishme të Kujdesit Parësor Shëndetësor, me rol thelbësor në mbrojtjen e shëndetit publik, veçanërisht të fëmijëve dhe grupeve të rrezikuara. Organizimi i këtij shërbimi është i strukturuar dhe i shtrirë në të gjitha njësitë shëndetësore të komunës, duke mundësuar qasje të lehtë dhe mbulim të plotë të popullatës



Vaksinimi i obligueshëm i fëmijëve realizohet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe në Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF), si dhe përmes ekipeve mobile në shkolla fillore dhe të mesme në territorin e komunës, si në zonat urbane ashtu edhe rurale. Përveç vaksinimit sipas kalendarit të rregullt imunizues, realizohet edhe vaksinimi kundër gripit sezonal dhe vaksime të tjera sipas nevojës epidemiologjike. Ky shërbim ofrohet nga profesionistë shëndetësorë të trajnuar, ndërsa ekipet e mjekësisë familjare kryejnë vlerësimin paraprak të gjendjes shëndetësore të fëmijëve përpara administrimit të vaksinave, duke siguruar siguri dhe standarde profesionale në procesin e imunizimit.



Gjatë vitit 2025 është realizuar një numër i konsiderueshëm i vaksinimeve, ku pjesa më e madhe i takon programit të rregullt të imunizimit të fëmijëve, ndërsa pjesa tjetër përfshin vaksinën BCG dhe Hepatit B të administruara në nivel spitalor.

Sa i përket mbulueshmërisë sipas grupmoshave, vërehet një nivel i lartë i vaksinimit tek fëmijët e vegjël dhe nxënësit e shkollave, ndërsa vaksinimi me HPV paraqet një komponent të rëndësishëm të programit preventiv për adoleshentët. Gjithashtu, tek maturantët është arritur një nivel shumë i lartë i vaksinimit, duke reflektuar një përfshirje të mirë të kësaj grupmoshe në programin imunizues.

Në krahasim me vitin paraprak, të dhënat tregojnë lëvizje të ndryshme në mbulueshmërinë vaksinale sipas grupmoshave, ku në disa kategori vërehet ulje e lehtë, ndërsa në të tjera përmirësim i dukshëm, veçanërisht tek maturantët. Kjo tregon nevojën për vazhdimësi në sensibilizim, organizim dhe monitorim të procesit të vaksinimit.

Sa i përket vaksinimit kundër gripit sezonal, është realizuar një mbulim i konsiderueshëm i popullatës, ku prioritet i është dhënë personave mbi moshën 65 vjeç, si grup më i rrezikuar, si dhe grupeve tjera si personeli shëndetësor dhe fëmijët. Krahasuar me vitet paraprake, numri i dozave të administruara tregon një trend relativisht stabil me luhate të vogla, duke reflektuar vazhdimësinë e programit të vaksinimit sezonal.

Në përgjithësi, programi i vaksinimit në komunë paraqet një komponent kyç të shëndetit publik, i cili kontribuon në parandalimin e sëmundjeve infektive, uljen e rrezikut epidemiologjik dhe përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm të popullatës, veçanërisht të fëmijëve dhe grupeve vulnerabël.

LABORATORI



Laboratori i Mjekësisë – Biokimi, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Gjakovë, përfaqëson një njësi të rëndësishme diagnostike që ofron shërbime laboratorike për të gjithë qytetarët e komunës. Shërbimet përfshijnë analiza biokimike, hematologjike, teste të hemostazës, analiza të urinës, si dhe matjen e HbA1C, duke mbuluar nevojat diagnostike në nivel të kujdesit parësor shëndetësor.

Falë pajisjeve moderne laboratorike dhe kapaciteteve të avancuara teknike, laboratori mundëson përpunimin e një numri të madh mostrash dhe realizimin e një spektri të gjerë analizash, duke kontribuar në diagnostikim të hershëm dhe

trajtim më efikas të pacientëve. Shërbimet laboratorike janë të organizuara në mënyrë të decentralizuar përmes laboratorëve të vendosur në disa Qendra të Mjekësisë Familjare, duke rritur qasjen e qytetarëve në shërbime dhe duke lehtësuar procesin e marrjes së analizave. Gjatë periudhës raportuese është evidentuar një volum i lartë i shërbimeve laboratorike, si për nga numri i analizave të realizuara, ashtu edhe për nga numri i pacientëve të shërbyer. Pacientët janë të shpërndarë në grupmosha të ndryshme, ku përfshihen fëmijët, të rinjtë, të rriturit dhe personat e moshuar, duke reflektuar mbulueshmërinë gjithëpërfshirëse të shërbimit laboratorik.

Nga muaji prill është evidentuar rritje e numrit të analizave laboratorike, ku përfshihen edhe analizat për vlerësimin e funksionit të gjëndrës tiroide. Kjo rritje reflekton rritjen e kërkesës për shërbime diagnostike dhe zgjerimin e gamës së analizave të ofruara në laborator.

Në përgjithësi, Laboratori i Biokimisë vazhdon të luajë një rol kyç në sistemin e kujdesit shëndetësor primar, duke siguruar rezultate të sakta, shërbim të shpejtë dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për mjekët familjarë në procesin e diagnostikimit dhe trajtimit të pacientëve

Gjatë periudhës raportuese për vitin 2025, në Laboratorin e Biokimisë janë realizuar gjithsej rreth 120,300 testime laboratorike, të kryera për 8,020 pacientë. Pacientët janë të shpërndarë në grupmosha të ndryshme, duke përfshirë fëmijët, të rinjtë, të rriturit dhe personat e moshuar, si vijon

Mosha	0–3 vjeç	3–10 vjeç	10–18 vjeç	19–65 vjeç	Mbi 65 vjeç
Nr. i pacientëve	502	793	1,549	2,471	2,705
Gjithsej	8,020				





KUJDESI PALIATIV

Kujdesi paliativ përbën një komponent të rëndësishëm të shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësor në komunën e Gjakovës, i cili synon përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve me sëmundje të rënda, progresive dhe të pashërueshme, si dhe ofrimin e mbështetjes së plotë për familjet e tyre gjatë gjithë fazës së sëmundjes.

Ky shërbim ofrohet nga ekipe multidisciplinare shëndetësore, të përbëra nga mjekë të mjekësisë familjare, infermierë dhe profesionistë tjerë shëndetësorë, të cilët bashkëpunojnë në mënyrë të koordinuar për menaxhimin e simptomave, lehtësimin e dhimbjes dhe ofrimin e kujdesit të vazhdueshëm mjekësor dhe infermieror. Kujdesi paliativ nuk fokusohet vetëm në aspektin mjekësor, por edhe në atë psikologjik, social dhe shpirtëror, duke e trajtuar pacientin dhe familjen si një tërësi.



Shërbimet e kujdesit paliativ përfshijnë vizita të rregullta në shtëpi, monitorimin e gjendjes shëndetësore, administrimin e terapisë, këshillimin e familjarëve për përkujdesje në kushte shtëpie, si dhe koordinimin me institucionet tjera shëndetësore në rastet kur kërkohet trajtim i specializuar apo hospitalizim. Një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të dinjitetit të pacientit dhe respektimit të nevojave individuale gjatë gjithë procesit të trajtimit.

Në kuadër të këtij shërbimi, Qendra për Kujdes Parësor Shëndetësor ka synuar të forcojë kapacitetet profesionale të stafit përmes trajnimeve dhe përfshirjes së praktikave bashkëkohore të kujdesit paliativ, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe standardizimin e tyre sipas udhëzimeve profesionale dhe etike.

Kujdesi paliativ në nivel komunal luan një rol të rëndësishëm në sistemin shëndetësor, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për pacientët në faza të avancuara të sëmundjes dhe duke kontribuar në lehtësimin e barrës emocionale dhe sociale të familjeve. Ky shërbim mbetet një nga shtyllat humane të sistemit shëndetësor, i orientuar drejt kujdesit, dinjitetit dhe mbështetjes së plotë të pacientit.

	NJËSIA	Vizitat					Total	Total	TOTAL	Total REFERIME	
		Vizita	vizita shtëpijake	Vizita në shtëpi (nëna dhe fëmijë)	Këshillimorja për Diabet	Kujdestari	Vizita	Sherbime	Vizita dhe sherbime	Teste rapid, lab biokimik	Spital,
1	QKMF e Re	47192	0	86	0	0	47278	84710	131988	3345	6320
2	QMF 1	19902		552	1700		22154	41349	63503	3737	2488
3	QMF / BERKOC	1956		14			1970	2859	4829	98	363
4	AMF - DOL	168					168	283	451	26	25
5	QMF / ORIZE	13517		111	1196		14824	21862	36686	1262	3074
6	QMF / ERENKU	6737		12			6749	6242	12991	701	728
7	QMF / PONOSHEC	2810		63		44	2917	6276	9193	271	228
8	AMF - GUSKË	109		1			110	343	453	1	0
9	AMF - KORENICË	537					537	807	1344	60	48
10	AMF - B. BOKES	181					181	296	477	8	7
11	AMF - MOLLIQ						0	0	0	0	0
12	AMF - SHEREMET	91					91	236	327	0	0
13	QMF / SKIVJAN	4741		77		84	4902	10383	15285	932	758
14	AMF - NOVOSELL	352					352	718	1070	41	57
15	QMF / CERMJAN	2567	2	23		66	2658	5724	8382	348	436
16	AMF - BEC	160					160	303	463	18	37
17	AMF - GERGOC						0	0	0	0	0
18	AMF - KRALAN	70					70	196	266	4	1
19	AMF - SHQIPONJË	247		11			258	978	1236	23	12
20	AMF - DOBLIBARE	156					156	203	359	4	18
21	QMF / ROGOVË	7357		160		225	7742	13832	21574	1511	836
22	AMF - BISHTAZH	4					4	9	13	1	0
23	AMF - LIPOVEC	95					95	664	759	12	12
24	AMF - DAMAJN	1207					1207	2184	3391	77	134
25	QMF / DARDANI	5405		22			5427	10300	15727	545	1084
26	URGJENCA	31197	2910				34107	50043	84150	365	2830
27	KËSHILLIMORJA			1823			1823	0	1823	0	0
28	KUJDESTARIT	17628					17628	30981	48609	1022	1995
29	SH. PENSIONIST	754					754	837	1591	114	35
30	KUJDESI PALIATIV	2169	1709				3878	4221	8099	2	45
TOTAL		167309	4621	2955	2896	419	178200	296839	475039	14528	21571

Pasqyra e shërbimeve shëndetësore në KPSH për periudhën Janar - Dhjetor 2025



Nr.	Përshkrimi	Nr.i vizitave	Nr.i shërbimeve	Viz.me pagesë	Viz.pa pagesë	Vlera në €
1	QKMF	2237	3910	375	1862	943.00
2	QMF 1	9036	15025	1276	7846	3853.00
3	QMF 3 Brekoc	260	826	33	227	71.50
4	QMF 4 Orize	1130	1955	78	1052	171.50
5	QMF 5 Erenik	284	454	30	254	53.50
6	QMF 6 Ponoshec	168	491	15	153	23.00
7	QMF 7 Cermjan	408	858	16	392	39.00
8	QMF 8 Skivjan	435	647	50	385	116.50
9	QMF 9 Rogovë	682	910	70	613	250.50
10	QMF 10 Dardani	369	724	35	334	70.50
11	Shk.fill. "M.Këpuska"	334	782	0	342	0.00
12	Shk.fill. "M.Bakija"	389	1033	0	389	0.00
13	Shk.fill. "Yll Morina"	454	1342	0	403	0.00
14	Shk.fill. "Z.Rexha"	335	844	0	335	0.00
15	Shk.fill. "F.Agani"	407	1118	0	386	0.00
16	Kujdestaria	1107	1633	255	835	281.00
	Gjithësej	18035	32552	2233	15808	5873.00

Tabela: Pasqyra e shërbimeve stomatologjike me pagesë dhe pa pagesë në KPSH Gjakovë për periudhën Janar - Dhjetor 2025

Shkollat	Vizitat nga Mjeku familjar	Vizitat nga Mjeku Stomatolog	Gjithsejt vizita sistematike në shkolla
Qytet	1375	1226	2601
Fshat	1414	1183	2597
Gjithsejt	2789	2409	5198


Tabela: Raporti i vizitave sistematike të nxënësve të shkollave fillore në komunën e Gjakovës

Shërbimet e vizitave në shtëpi kanë vazhduar të ofrohen nga ekipet e Kujdesit Parësor Shëndetësor, me fokus të veçantë tek fëmijët e moshës së hershme dhe gratë shtatzëna. Këto vizita kanë pasur për qëllim monitorimin e gjendjes shëndetësore, ofrimin e këshillimeve profesionale dhe sigurimin e përkujdesjes shëndetësore në ambientin familjar.

Përmes këtyre shërbimeve është synuar përmirësimi i kujdesit preventiv dhe mbështetja e vazhdueshme për kategoritë më të ndjeshme të popullsisë, duke ndikuar në ruajtjen dhe avancimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Nr.	Numri i vizitave në shtëpi	Totali 2023	Totali 2024	Totali 2025
1	Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç	3214	3222	2668
2	Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna	377	365	178
	Numri total i vizitave në shtëpi	3591	3587	2846

Tabela paraqet numrin e vizitave në shtëpi të realizuara nga ekipet e Kujdesit Parësor Shëndetësor gjatë viteve 2023, 2024 dhe 2025



MAMOGRAFIA – Shërbimi i Mamografisë, i cili funksionon në kuadër të QKMF-së në Gjakovë, vazhdon të ofrojë kontrolle diagnostikuese për pacientët e referuar. Gjatë vitit 2025, në Qendrën e Mamografisë në QMF “Ereniku” janë realizuar gjithsej 917 mamografi, prej tyre 905 për femra dhe 12 për meshkuj. Gjithashtu, nga numri i përgjithshëm i pacientëve, 82 kanë qenë pjesëtarë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Për sigurimin e interpretimit profesional të rezultateve, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DShMS), nga data 17.10.2024, ka kontraktuar shërbime konsulente të mjekëve specialistë – radiologë për Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH), për leximin e mamografive

MBËSHTETJA FINANCIARE PËR PERSONAT QË VUAJNË NGA SËMUNDJET E RËNDA.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shpallur Thirrjen Publike për Subvencionim në fushën e Shëndetësisë.

Gjatë periudhës është hapur Thirrja Publike për subvencionim në fushën e shëndetësisë, ku janë pranuar aplikacionet për mbështetje financiare dhe janë realizuar pagesat për përfituesit e përzgjedhur.

Prioritet në listën e përfituesve u është dhënë: Personave me sëmundje të rënda dhe me kosto të lartë të trajtimit; Personave që nuk kanë përfituar nga burime të tjera financiare; Personave që nuk kanë përfituar gjatë dy viteve të fundit; Personave në kushte të rënda socio-ekonomike.

Viti 2025 jan mbeshtetur 183 perfitues ne vlere 60,000 euro ndersa ne vitin 2026 jan mbeshtetur 243 perona me vlere 81.300 euro.

Gjatë vitit 2025, në kuadër të Thirrjes Publike për Subvencionim në fushën e Shëndetësisë, janë mbështetur gjithsej 183 përfitues, me një vlerë të përgjithshme prej 60,000.00 euro.

Ndërsa gjatë vitit 2026, janë mbështetur gjithsej 243 persona, me një vlerë të përgjithshme prej 81,300.00 euro.



Në krahasim me vitin 2025, në vitin 2026 është shënuar:

- Rritje prej 32.8% në numrin e përfituesve (60 përfitues më shumë);
- Rritje prej 35.5% në vlerën e mjeteve të ndara (21,300.00 euro më shumë).

Këto të dhëna tregojnë një rritje të konsiderueshme të përfshirjes së qytetarëve në skemat e mbështetjes sociale dhe shëndetësore, si dhe rritje të kapaciteteve buxhetore të dedikuara për këtë qëllim.

Mbështetja financiare për Organizatat Joqeveritare (OJQ)

Në kuadër të realizimit të Thirrjes së parë Publike për mbështetjen e Organizatave Joqeveritare, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka bërë shpërndarjen e mjeteve financiare në përputhje me kriteret e përcaktuara në thirrjen publike dhe rregulloren përkatëse për subvencione komunale.

Shuma e përgjithshme e planifikuar për këtë thirrje për vitin 2025 ka qenë **37,500.00 euro**, e cila është dedikuar për mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve të OJQ-ve që veprojnë në fushën e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe përmirësimit të shërbimeve për kategoritë e ndjeshme të shoqërisë.

Nga kjo thirrje, kanë përfituar këto organizata:

NR.	ORGANIZATA JOQEVERITARE (OJQ)	SHUMA E PËRFITUAR (€)
1	OJQ "Medica Kosova"	4,000.00 €
2	OJQ "Kryqi i Kuq i Kosovës"	3,500.00 €
3	OJQ "Instituti për Barazi Gjinore"	2,500.00 €
4	OJQ "Handikos – Gjakova"	25,000.00 €
5	OJQ "It's Worth Living / Ia vlen të Jetosh"	2,500.00 €

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Funksionimi i Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë mbështetet në një bazë të konsoliduar ligjore, e cila rregullon ofrimin e shërbimeve sociale, mbrojtjen e familjes dhe garantimin e të drejtave të kategorive në nevojë. Ligjet dhe aktet kryesore mbi të cilat mbështetet veprimtaria e QPS-së janë:

- Ligji mbi Familjen
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
- Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore
- Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
- Ligji për Përkrahjen e Familjeve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara
- Udhëzimi Administrativ për Strehimin Familjar
- Procedurat dhe standardet e veprimit në shërbimet sociale
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
- Ligji mbi Procedurën Administrative
- Udhëzimet administrative
- Procedurat dhe standardet e veprimit



Këto akte ligjore dhe nënligjore përbëjnë themelin mbi të cilin ndërtohet organizimi dhe funksionimi i QPS-së, duke përcaktuar qartë kompetencat institucionale, përgjegjësitë e stafit dhe mënyrën e trajtimit të rasteve. Në mënyrë konkrete, ato ndikojnë drejtpërdrejt në strukturimin e brendshëm të Qendrës në sektorë funksionalë, siç janë Shërbimet Sociale Familjare, Shërbimi i Asistencës Sociale dhe Shërbimi Administrativ dhe Financiar.

Përmes kësaj ndërlidhjeje, organizimi institucional i QPS-së reflekton kërkesat ligjore për ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe profesionale, duke mundësuar zbatim më efikas të politikave sociale dhe mbrojtje më të mirë të të drejtave të qytetarëve. Njëkohësisht, ky kuadër krijon bazën për standardizimin e praktikave profesionale dhe për rritjen e llogaridhënies institucionale.

Struktura Organizative

Qendra për Punë Sociale në Gjakovë është e organizuar mbi një strukturë funksionale të ndarë në sektorë kyç, në krye të institucionit qëndron Udhëheqësja e Qendrës, e cili është përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të punës.

Struktura organizative përfshin Shërbimin e Shërbimeve Sociale Familjare, Shërbimin e Asistencës Sociale, si dhe Shërbimin Administrativ dhe Financiar, i cili luan rol mbështetës thelbësor në funksionimin e institucionit. Ky i fundit siguron menaxhimin e proceseve administrative, financiare dhe buxhetore, duke garantuar mbarëvajtjen teknike dhe efikase të punës së përgjithshme të Qendrës.

Shërbimet Kryesore

Në komunën e Gjakovës, skema e ndihmës sociale zbatohet përmes Qendrës për Punë Sociale, e cila ka rol kyç në identifikimin, vlerësimin dhe përfshirjen e familjeve në nevojë në këtë skemë. Kjo skemë synon të ofrojë mbështetje financiare për familjet që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe që nuk kanë burime të mjaftueshme për sigurimin e një jetese minimale.

Procesi i përfitimit nga ndihma sociale realizohet përmes një procedure të strukturuar institucionale, në përputhje me Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale dhe aktet përkatëse nënligjore. Fillimisht, aplikimi bëhet në QPS, ku palët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtim. Pas pranimit të kërkesës, bëhet verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit, si



dhe kompletimi i dosjes së rastit në përputhje me kriteret ligjore dhe procedurat administrative. Në vijim, realizohet verifikimi në terren nga një komision verifikues i përbërë nga tre (3) anëtarë, ku njëri prej tyre është menaxheri i rastit. Ky komision vepron në bazë të standardeve profesionale dhe procedurave të miratuara, duke vlerësuar në mënyrë objektive gjendjen socio-ekonomike të familjes. Pas përfundimit të vizitës në terren, komisioni harton një raport të detajuar, në të cilin përfshihen të gjeturat faktike, analiza e gjendjes dhe rekomandimet profesionale lidhur me përfitimin nga skema.

Ky raport i përcillet Zyrtarit të Lartë për Asistencë Sociale, i cili, në përputhje me kompetencat ligjore dhe mbi bazën e dokumentacionit dhe rekomandimeve të komisionit verifikues, merr vendimin përfundimtar për përfshirjen ose refuzimin e kërkesës. Vendimmarrja bazohet në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe transparencës, duke siguruar një proces të drejtë dhe të verifikueshëm administrativ.

Kjo procedurë e strukturuar pasqyron ndërlidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet kuadrit ligjor dhe praktikës institucionale, duke garantuar që çdo vendim të jetë i bazuar në evidenca dhe në përputhje me standardet profesionale. Në praktikë, skema e ndihmës sociale në Gjakovë luan një rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë dhe mbështetjen e kategorive më të cënueshme, megjithatë vazhdon të përballët me sfida që lidhen me kufizimet buxhetore, kriteret e përfshirjes dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të mekanizmave të vlerësimit.

Shërbimet që ofrohen nga Shërbimi Social

1	Vendosja e fëmijëve nën kujdestari	20	Trajtimi i fëmijëve përdorues të substancave	41	Viktimat e krimeve seksuale	63	Propozim për heqje të të drejtës prindërore	84	Vërtetime për kujdestari
2	Vendosja e fëmijëve të braktisur në spital	21	Fëmijët në konflikt me ligjin (nën 14 vjet)	42	Viktimat e trafikimit	64	Propozim për heqje të zotësisë së veprimit	85	Vërtetime për prind vetushqyes
3	Vendosja e fëmijëve në shtëpi tranzitore	22	Fëmijët në konflikt me ligjin (14–16 vjet)	43	Mendim profesional për gjykatë	65	Mendim për person të zhdukur	86	Vërtetime për asistencë sociale (jo përfitues)
4	Strehimi familjar brenda familjes biologjike	23	Fëmijët në konflikt me ligjin (16–18 vjet)	44	Zhvendosje ndërmjet institucioneve	66	Vlerësimi i riatdhesuarve	87	Vërtetime për asistencë sociale (përfitues)
5	Strehimi familjar jashtë familjes biologjike	24	Mbikëqyrje e shtuar	45	Referim në institucione rezidenciale	67	Strehim për persona me aftësi të kufizuara	88	Konstatim i gjendjes jetësore
6	Bashkimi familjar	25	Rikthim në arsim	46	Shërbime për viktimat konfliktesh	68	Vendosje në shtëpi për të moshuar	89	Përkrahje materiale nga skemat sociale
7	Adoptimi vendor	26	Kontakt fëmijë–prindër	47	Kujdestari për të rritur	69	Mbrojtja e riatdhesuarve	90	Pranimi i kërkesave
8	Adoptimi ndërkombëtar	27	Bashkëpunim me institucione	48	Vlerësim profesional dhe plan individual	70	Përkrahje materiale për strehim familjar	91	Verifikimi në terren
9	Vizita pas adoptimit	28	Referim për rrëmbim ndërkombëtar	49	Sanimi i marrëdhënieve familjare	71	Përkrahje materiale jashtë familjes	92	Nxjerrja e vendimeve
10	Përcjellja para adoptimit	29	Kujdestari ligjor – këshillim	50	Këshilla martesore	72	Përkrahje për fëmijë me aftësi të kufizuara	93	Referimi në skema tjera
11	Strehimi i fëmijëve të keqtrajtuar	30	Referim për rrëmbim vendor	51	Anamnezë sociale	73	Ndihma emergjente	94	Shërbime tjera
12	Vlerësimi profesional dhe plan individual	31	Mendim për martesë të të miturve	52	Përfaqësim në gjykatë	74	Avokim për ndihma		
13	Këshillim psiko-social dhe edukativ	32	Fëmijët me aftësi të kufizuara	53	Trajtimi i personave me ngecje mendore	75	Shpërndarja e ndihmave		
14	Vizita në familje, shkollë dhe komunitet	33	Fëmijët në situatë rruge	54	Trajtimi i personave me aftësi të kufizuara	76	Intervenim jashtë orarit		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



15	Kujdestari special	34	Referim në programe profesionale	55	Trajtimi i viktimave të dhunës	77	Pëlqim për udhëtim		
16	Marrja e deklaratës nga fëmija	35	Regjistrim i mëvonshëm i fëmijëve	56	Trajtimi i viktimave të trafikimit	78	Ndihma në dokumentacion		
17	Përfaqësimi në seanca gjyqësore	36	Jetesa e pavarur	57	Trajtimi i viktimave të krimeve seksuale	79	Pëlqim për pasuri		
18	Fëmijët me ngecje në zhvillim	37	Strehim komunitar për aftësi të kufizuara	58	Rehabilitim dhe riintegrim	80	Konstatim për prind të vetëm		
19	Reintegrim dhe rehabilitim	38	Strehim i përkohshëm	59	Referim në punësim	81	Vërtetime financiare		
		39	Strehim në qendra ditore	60	Trajtimi i përdoruesve të alkoolit	82	Vërtetime për shtetësi		
		40	Viktimat e dhunës në familje	61	Trajtimi i përdoruesve të substancave	83	Vërtetime për aftësi veprimi		

Kategoria e Klientit	Numri i Kërkesave	Numri i rasteve në procedurë	Numri i rasteve të kryera	Resurset
1.Femijet e Braktisur	0	0	0	QPS - DPSF- Spitali
2.Femijet jetim	0	0	0	QPS - Komuna
3.Prindërit e penguar në ushtrimin e së drejtës prindërore	1	0	1	QPS - Gjykata DPSF
4.Strehimi familjar për fëmijët	1	0	1	QPS – Familje str. DPSF
5.Strehimi tek të afërmit për fëmijët	6	0	6	QPS – Familja DPSF
6.Strehimi i fëmijëve në institucione tjera	1	0	1	QPS - DPSF inst strehuese
7.Fëmijët me aftësi të kufizuar	50	2	48	QPS – DPSF
8.Të miturit me sjellje delikvente	125	1	124	QPS – Polica - Gjykata
9.Fëmijët me sjellje asociale	0	0	0	QPS – Policia – Gjykatat
10.Kërkesë për dëgjimin e fëmijë	73	0	73	Policia - Prokuroria
10.Trajtime Psiko-Sociale	40	25	15	QPS – Familja – Policia – Prokuroria – Shkolla, etj.
11.Regjistrimi i fëmijëve	1	1	0	QPS - Komuna
12.Fëmijët në punë	0	0	0	QPS - Komuna, Policia, Shkolla, Komuniteti
13. Fëmijët në situatë rruge, të abuzuar, keqtrajtuar, neglizhuar, etj.	40	20	2	QPS - Komuna, Policia, Shkolla, Komuniteti
14.Fëmijët- viktimat të trafikimit Ngacim seksual, sulm seksual, dhunim seksual	0 3	0 3	0	QPS - Policia ,Familja
15.Mendim për kurorëzim të parakohshëm	1	0	1	QPS - Gjykatat
16.Bashkëjetes e hershme nën moshën e lejuar	3	3	0	Polici- Prokurori
16.Bashkimi familjar – Riatdhesim i fëmijëve dhe të rriturve	0	0	0	QPS –Familja
17.Kujdestaria ndaj fëmijëve	11	0	11	QPS – Familja
18.Kerkesa Adoptimi të fëmijëve të braktisur	0	0	0	QPS – DPSF Gjykatat
19.Kujdestaria për të rritur	3	0	3	QPS - Gjykatat
20.Familjet potenciale strehuese	0	0	0	QPS – DPSF
21.Familjet potenciale adoptuese	0	0	0	QPS – DPSF Gjykatat
22.Mendim për adoptim	1	0	1	QPS – DPSF Gjykatat
23.Besimi i fëmijëve nga QPS	0	0	0	QPS
24.Mendim për besimin e fëmijëve të kërkuara nga Gjykatat	62	10	52	QPS - Gjykatat



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



25.Procedurat e pajtimit dhe mendim për besimin e fëmijëve	52	10	42	QPS - Gjykata
26.Dhuna në familje Dhuna Seksuale	1471	421	1050	QPS – DPSF Strehimoret. Gjykata
27. Aktvendim për Urdhër Mbrojtje nga Dhuna ne Familje	17	17	0	Gjykata, Policia
27.Probleme familjare	38	18	20	QPS
28.Kontaktimet	35	15	20	QPS, Gjykata
29.Pranim i atësisë, amësisë	2	0	2	QPS, Familja, Institucione tjera
30.Personat me sëmundje psiqike	0	0	0	QPS - shëndeti mendor
31.Të rriturit dhe të moshuarit në nevojë për shërbime	22	2	20	QPS – DPSF inst strehuese
32.Përfaqësim në gjykatë për fëmijë dhe të rritur	229	29	200	QPS - Gjykata
33.Përfaqësim në polici dhe prokurori për të mitur	241	0	241	QPS
34. Njoftim për kallëzim penal	36	16	20	Prokuroria
35. Të tjera: autorizime, vërtetime, procesverbale, aktvendime, pëlqime, konstatime anamneza sociale etj.	1877	0	1877	QPS – Familja Gjykata.
Gjithsej numri i rasteve	3083	197	2886	

Raporti Vjetor Janar - Dhjetor 2025 – (Sektori i Shërbimeve Sociale)

Tabela paraqet ecurinë mujore të familjeve përfituese të ndihmës sociale, numrin e anëtarëve të përfshirë në këtë skemë si dhe mbështetjen financiare të ndarë gjatë vitit raportues. Të dhënat tregojnë angazhimin institucional në ofrimin e mbështetjes sociale për familjet në nevojë, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe sigurimit të përkrahjes financiare për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë.

Gjithashtu, tabela pasqyron ndryshimet mujore në numrin e përfituesve dhe shumat financiare të shpërndara, në përputhje me gjendjen dhe nevojat e familjeve përfitue

Tabela paraqet numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë sociale

Muaji	Numri i Familjeve	Numri i Antareve	Shuma Financiare
Janar	969	3878	125.000.00
Shkurt	971	3875	124.950.00
Mars	976	3912	125.940.00
Prill	956	3832	123.450.00
Maj	947	3803	122.410.00
Qershor	943	3790	122.410.00
Korrik	935	3739	120.800.00
Gusht	929	3723	119.970.00
Shtator	916	3660	118.030.00
Tetor	925	3704	143.474.00
Nentor	921	3685	142.766.00
Dhjetor	920	3670	142.262.00



PAGESA E QIRASË PËR FAMILJET NË NEVOJË – VITI 2025

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, gjatë vitit 2025, ka realizuar pagesën e qirasë për familjet në nevojë, në kuadër të mbështetjes sociale për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë.

Sipas kriterëve të përcaktuara, prioritet në këtë kategori u është dhënë:

- Nënave vetushqyese;
- Rasteve sociale pa strehim (pa kulm mbi kokë);
- Rasteve të dhunës në familje.

Gjatë kësaj periudhe është realizuar mbështetja financiare për 4 familje në nevojë, të cilat kanë plotësuar kriteret e përcaktuara.

Kjo formë e mbështetjes ka pasur për qëllim lehtësimin e kushteve të jetesës për familjet në gjendje të rëndë socio-ekonomike, si dhe ofrimin e ndihmës emergjente për strehim të përkohshëm.

Aktivitetet dhe Arritjet

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Qendrën për Punë Sociale në Gjakovë është pesëmbëdhjetë (15), ndërsa ky kapacitet institucional pritët të rritet me angazhimin e tre (3) zyrtareve të reja nga fusha e psikologjisë dhe shkencave sociale. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të kapaciteteve profesionale të Shërbimeve Sociale, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së trajtimit të rasteve dhe në rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve sociale. Në funksion të avancimit profesional, gjatë vitit janë realizuar një numër i konsiderueshëm trajnimesh, të organizuara si nga institucionet qendrore përkatëse, ashtu edhe nga organizata vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Këto trajnime kanë pasur për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, përditësimin e njohurive në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në fushën e punës sociale, si dhe harmonizimin e praktikave me standardet profesionale dhe etike të kërkuara. Në këtë kontekst, rritja e vazhdueshme e cilësisë së shërbimeve sociale paraqitet si një domosdoshmëri, duke marrë parasysh se ofrimi i këtyre shërbimeve duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara ligjore dhe profesionale, ndryshe nga qasjet më të kufizuara që kanë karakterizuar periudhat e mëhershme.

Nga aspekti organizativ, shërbimet kryesore të Qendrës funksionojnë në mënyrë të strukturuar dhe të koordinuar, duke u bazuar në planin dhe programin vjetor të punës, si dhe në rregulloret dhe aktet e brendshme që përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e stafit. Kjo qasje siguron një funksionim të qëndrueshëm institucional dhe një shpërndarje më efikase të përgjegjësi në përmbushjen e detyrave të përditshme profesionale. Në kuadër të Shërbimeve Sociale në thirrmi që funksionon edhe Organi i Kujdestarisë, (duhet të funksionalizohet Organi i Kujdestarisë) i cili përfaqëson një mekanizëm thelbësor për mbrojtjen e kategorive më të cënueshme. Ky organ operon në gatishmëri të vazhdueshme 24/7, duke mundur reagim të menjëhershëm ndaj rasteve urgjente. Zyrtarët përgjegjës janë në dispozicion të vazhdueshëm dhe, në bashkëpunim me institucione të tjera relevante si policia, shëndetësia dhe organet e drejtësisë, ndërhyjnë në terren për trajtimin e rasteve, përfshirë edhe prezencën në stacionet policore kur kërkohet. Përmes këtij mekanizmi sigurohet ndërhyrje e shpejtë, vlerësim profesional i situatës dhe koordinim ndër-institucional, me qëllim mbrojtjen e interesit më të mirë të individit dhe familjes. Në tërësi, organizimi aktual dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit në QPS Gjakovë reflekton përpjekjet për ndërtimin e një sistemi funksional dhe të standardizuar të shërbimeve sociale, i cili synon të jetë më efikas, më i përgjegjshëm dhe më i orientuar drejt nevojave reale të qytetarëve.

Projektet e Realizuara

Projekti për Reformën e Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë ka filluar më 20 maj 2024. Qëllimi i projektit është përmirësimi i drejtësisë dhe përshtatshmërisë së rrjetit të mbrojtjes sociale, duke u fokusuar në identifikimin e familjeve të varfra dhe integrimin e tyre në tregun e punës.

Institucioni përgjegjës për zbatimin e projektit është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), në bashkëpunim me Bankën Botërore.

Detyrat kryesore përfshijnë:

- Asistimin e stafit të QPS-ve në aktivitetet ditore për zbatimin e SAS Pilotimit.
- Mbështetjen e aplikantëve gjatë procesit të aplikimit.
- Shpërndarjen e informacionit tek qytetarët dhe ndihmën për hapjen e llogarive e-Kosova dhe Gmail.



- Aplikim për shtesa dhe lehona, aplikim për libra, aplikim për subvencion të energjisë elektrike si dhe shumë aplikime që kanë të bëjnë në E-Kosova.
- Pjesëmarrjen në punëtori dhe sesione trajnuese.
- Ndhimën në vizitat në terren dhe raportimin e aktiviteteve.
- Mbështetjen e QPS-ve në programe të tjera të mbrojtjes sociale.

Bashkëpunimi me institucione/Organizata

Qendra për Punë Sociale ka bashkëpunim të vazhdueshëm me institucione publike dhe organizata të ndryshme, me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore dhe gjithëpërfshirëse për qytetarët.

Bashkëpunimi me institucionet: Policinë e Kosovës, Prokurorinë Themelore, Gjykatën Themelore, Mbrojtësin e viktimave, Shërbimin sprovues.

Qendra për Punë Sociale bashkëpunon me: Drejtorinë e Shëndetësisë (për subvencionim të rasteve emergjente), Spitalin rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, Qendrën e Shëndetit Mendor, QKMF-në në Gjakovë etj.

Bashkëpunimi përfshin trajtimin e rasteve me nevoja shëndetësore, vlerësime profesionale dhe mbështetje për kategori të cenueshme.

Bashkëpunimi me institucionet arsimore Shkollat fillore dhe të mesme në komunë. Ky bashkëpunim realizohet përmes referimit dhe trajtimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje sociale, si dhe ndërhyrjeve në rastet e braktisjes, dhunës apo neglizhencës.

Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike si: Shërbimin e gjendjes civile, Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Ministrinë e punëve të brendshme, Ministrinë e punëve të jashtme. Ky bashkëpunim është i rëndësishëm për realizimin e të drejtave administrative dhe sociale të qytetarëve.

Bashkëpunimi me institucionet rezidenciale dhe të përkujdesjes: Shtëpinë e personave të moshuar, Institucionin në shtime, Shtëpitë në komunitet në Prishtinë, Gurakoc, Deçan dhe Prizren. Ky bashkëpunim ka për qëllim akomodimin dhe përkujdesjen afatshkurtër apo afatgjatë të personave në nevojë.

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare (OJQ) lokale: Shtëpinë e Sigurt në Gjakovë, Strehimin rezidencial për fëmijë në Gjakovë, Kryqin e Kuq, Handikos, Medica Gjakova, Medica Kosova. Këto organizata ofrojnë shërbime mbështetëse si strehim, rehabilitim, këshillim psikosocial dhe ndihmë humanitare.

Qendra për Punë Sociale bashkëpunon me: Save the Children, UNICEF, KOMF, OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve. Ky bashkëpunim përfshin projekte zhvillimore, ngritje të kapaciteteve profesionale dhe përmirësim të shërbimeve sociale.

Trajnimet dhe Ngritjet e Kapaciteteve

Stafi i Qendrës për Punë Sociale ka pasur trajnim të vazhdueshëm në fushën e menaxhimit dhe trajtimit të rasteve, përfshirë trajtimin e rasteve të dhunës në familje, strehimin familjar, mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, personave të riatdhesuar, si dhe fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Trajnimet janë realizuar nga organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, ku një pjesë e tyre janë zhvilluar në bashkëpunim me Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili ka lëshuar edhe certifikata përkatëse për pjesëmarrësit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Pershkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Saldo	% e shp.
Administrata/10	73,125.34	73,122.18	3.16	100.00
Paga	63,125.34	63,125.34	-	100.00
M e sh	10,000.00	9,996.84	3.16	99.97
Kpsh/10	4,831,197.09	4,807,388.79	23,808.30	99.51
Paga	3,800,504.09	3,800,504.09	-	100.00
M e sh	630,693.00	606,922.10	23,770.90	96.23
Komunalet	80,000.00	79,962.60	37.40	99.95
Subvencionet	30,000.00	30,000.00	-	100.00
Kapitalet	290,000.00	290,000.00	-	100.00
Renovimi i obj te qmf,orize,dardani dhe erenik	100,000.00	100,000.00		100.00
Ndertimi i obj.te b.s.	190,000.00	190,000.00	-	100.00
Qps/10	376,641.04	376,616.94	24.10	99.99
Paga	148,641.04	148,641.04	-	100.00
M e sh	30,000.00	29,988.53	11.47	99.96
Komunalet	8,000.00	7,999.27	0.73	99.99
Kapitalet	190,000.00	189,988.10	11.90	99.99
Reovimi i objektit eksistues te banimit social	190,000.00	189,988.10	11.90	99.99
Rezidenciale/10	488,713.51	488,664.14	49.37	99.99
Paga	8,713.51	8,713.51	-	100.00
M e sh	45,000.00	44,950.63	49.37	99.89
Komunalet	5,000.00	5,000.00	-	100.00
Kapitalet	430,000.00	430,000.00	-	100.00
Ndertimi i shtepise per pers.te moshuar	200,000.00	200,000.00	-	100.00
Ndertimi i shtepise per mbrojt.e femijeve	230,000.00	230,000.00	-	100.00
Kpsh/21	100,000.00	99,800.50	199.50	99.80
Subvencionet	100,000.00	99,800.50	199.50	99.80
Qps/21	10,000.00	9,192.04	807.96	91.92
Subvencionet	10,000.00	9,192.04	807.96	91.92
Kpsh/22	60,752.35	56,798.35	3,954.00	93.49
Ndertimi i banimit soc.faza ii	60,752.35	56,798.35	3,954.00	93.49
Totali i buxhetit	5,940,429.33	5,911,582.94	28,846.39	99.51
Te hyrat e krijuara/2025		108,882.40		

Tabela buxhetore e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale paraqet planifikimin dhe realizimin e mjeteve financiare për vitin 2025